

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT "ERGYS M. SINANI"

Nr. 591 Prot

Tiranë, më 28.07.2021

Nr.123 Dosje

URDHËR

(PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar: QËNDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Adresa: Blv. "Zhan D`Ark", Prona nr.33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë

Për dijeni: Debitorit - Shoqëria "BLERON - 01" sh.p.k. me NUIS L63426801O

*Adresa: Lekaj LUZ I MADH Fshati Luz i Madh, rruga e Re, objekt 1-katesh,
godina nr.1, Zona kadastrale 2583, Pasuria nr 106/27, 106/28, Tiranë*

Për dijeni : Kreditorit – Shoqëria "EDIPACK" Sh.p.k., identifikuar me NUIS J61818524A

Adresa : "Aleksandër Goga", Porto Romano, Durrës

Unë, Ergys M. Sinani , me detyrën e Përbaruesit Gjyqësor Privat, në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. (11-2021-3703) 811 datë 17/05/2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përbarimore Nr. 123 , datë 07.07.2021 kërkesën e kreditorit Shoqëria "EDIPACK" Sh.p.k., identifikuar me NUIS J61818524A ndaj debitorit Shoqëria "BLERON - 01" sh.p.k. me NUIS L63426801O, në lidhje me titullin ekzekutiv "Fatura tatimore; Nr. 3016 date 31/10/2020".

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorëve Lajmërimin Nr. 351 Prot, datë 07.07.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. (11-2021-3703) 811 datë 17/05/2021 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

KONSTATOVA Se :

Debitori Shoqëria "BLERON - 01" sh.p.k. me NUIS L63426801O, kanë marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i janë përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorëve Shoqëria "BLERON - 01" sh.p.k. me NUIS L63426801O, në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të neneve 36 pika (b), 37 pikat (b ; c) dhe 46 të Ligjit Nr.26/2019, datë 8.5.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ


1. Qëndrën Kombëtare të Biznesit , të bëjë bllokimin e kapitalit të regjistruar apo çdo të drejtë tjetër në subjektet tregëtare , që zotërohen dhe janë të regjistruar në emër të debitorit , duke regjistruar shënimin:

➤ Shoqëria "BLERON - 01" sh.p.k. me NUIS L634268010, adresë Lekaj LUZ I MADH Fshati Luz i Madh, rruga e Re, objekt 1-katesh, godina nr.1, Zona kadastrale 2583, Pasuria nr 106/27, 106/28, Tiranë

"Ndalimin e tjetërsimit të pasurive të luajtëshme dhe të paluajtëshme dhe të drejtave reale mbi kreditë e debitorit Shoqëria "BLERON - 01" sh.p.k. me NUIS L634268010 me administrator Arjan Lazaj, duke paralajmëruar çdo zyrë noteriale se çdo akt I ndërmarrë pas regjistrimit në regjistrat e QKB-së këtij urdhëri sekuestroje konservative , përbën shkelje ligjore referuar nenit 531 e vijues të K.Pr.Civile, të Ligjit nr. 7829 dt. 01.06.1994 "Per noterine" I ndryshuar ,dhe neneve 428 dhe 320 te Kodit Penal".

2. Ky urdhër të qëndrojë i regjistruar në regjistrin e QKB-së deri në shlyerjen e plotë të detyrimit në zbatim të urdhërit të ekzekutimit Nr. (11-2021-3703) 811 datë 17/05/2021 lëshuar prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
3. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
4. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së kuotave/aksioneve apo çdo të drejtë tjetër në emër të debitorit të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Proçedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.
5. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

PËRMBARUESI I SHQËRSOR PRIVAT


ERGYS M. SHANI